



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 938 Prot.

Tiranë, më 02. 07. 2018

V E N D I M

Nr. 144, Datë 02. 07. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 95, datë 26.06.2018, e shtetasit I. K., përfaqësuar¹ nga A. G., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR), me pretendim diskriminimin për shkak të moshës².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. K. sqaron se, ka punuar në pozicionin e Pranuesit të Dokumentacionit të Rregjistrimit të Mjeteve, në DPSHTRR, nga viti 2006 deri më datë 05.10.2017. Sipas tij, gjatë detyrës së ushtruar, ka punuar me përkushtim në pozicione të ndryshme pune duke u vlerësuar me pozitivisht nga eprorët. Në muajin Shtator 2017, është vënë në dijeni të shkresës “*Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të riskstrukturimit të institucionit*” dhe më datë 7 Janar 2018, punëdhënësi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.

¹ Me Prokurë të Posaçme Nr. 358/2 Kol., datë 06.06.2018, nga A. G., me profesion Avokat.

² Pasi ankuesi është 60 vjeç

I ndodhur në këtë situatë, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga punëdhënësi i tij gjatë procedurave për largimin nga puna, pasi arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nuk lidhen me ristrukturimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, por me moshën e tij.

Përsa me lart, në vijim të trajtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të e-mailit, datë 26.06.2018, i kërkoi përfaqësuesit ligjor të ankuesit, A. G., informacion shtesë mbi shkakun e diskriminimit dhe kopje të kërkesë-padisë së paraqitur në gjykatë lidhur me largimin nga puna.

Në përgjigje të e-mailit të Komisionerit, A. G. më datë 28.06.2018 sqaroi se, në institucionin ku ka punuar ankuesi nuk ka persona të tjerë në moshën e tij. Gjithashtu, A. G. vuri në dispozicion të Komisionerit, një kopje të kërkesë padisë së paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me largimin nga puna.

Mbështetur në kopjen e Kërkesë-Padisë³ së depozituar pranë KMD-së më datë 27.06.2018, ankuesi ka paditur në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, Institucionin e DPSHTRR-së, me objekt *“...dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes pa shkaqe të arsyeshme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës etj...”*.

Gjatë arsyetimit të kërkesë padisë, së bërë nga ana e Gjykatës e Shkallës së Parë Tiranë, në faqen 9 (nëntë) të saj, ankuesi ka parashtruar se, mbështetur në Nenin 1 të Ligjit Nr. 10221 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, diferencimi që ka bërë punëdhënësi ndaj punëmarrësit I. K., i referohet pikërisht moshës së tij, sepse ai është 60 vjeç.

Gjithashtu, referuar bazës ligjore të cituar në kërkesë-padi, është vendosur ndër të tjera edhe Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Në këto kushte, I. K., në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka pretenduar trajtimin e disfavorshëm dhe diskriminues për shkak të moshës, duke e larguar nga puna.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadija në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht*

³ Kërkesë Padi e depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më datë 27.06.2018.

objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 95 Regj., datë 26.06.2018, e shtetasit I. K., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.**

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36, paragrafi 3, të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1,3,5,7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 2 e 3 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit e ankesës Nr. 95 Regj, datë 26.06.2018, e shtetasit I. K., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për shkak se çështja është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Moshë)

(Fusha: Punësim)